



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

Nr. 3052 / Prot.

Tiranë, më ____/____/2018

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data]

Për: **Montal Sh.p.k NIPT J62009007F, Adresë: Tiranë, "Dervish Hima", 3 kullat K.3, AP 9/2**, përfaqësues me prokurë të posaçme i bashkimit të bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë Montal me NIPT J62009007F Adresë: Tiranë, "Dervish Hima", 3 kullat K.3, AP 9/2 dhe Biometric Albania Sh.p.k me NIPT J61827062E Adresë Tiranë, Rr "Vllazen Huta" Pallat i Ri Vila Park, Kati 6.

* * *

Procedura e prokurimit: Procedure e hapur- mallra- prokurim me mjete elektronike.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-67865-05-08-2018

LOT1 – REF-67874-05-08-2018

LOT2 – REF-67870-05-08-2018

LOT3 – REF-67872-05-08-2018

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **"Furnizim vendosje pajisje mjekësore dhe hotelerie për godinën e maternitetit të Spitalit Korçë dhe për për kirurgjinë e re dhe patologjinë e spitalit Sarandë"** me fond limit në total **130,044,395 (njëqind e tridhjetë milion e dyzet e katër mijë treqind e nëntëdhjetë e pesë) Lekë pa TVSH** i ndarë në lote si më poshtë:

Lot 1: "Furnizim vendosje pajisje mjekësore dhe pajisje mobilimi spitalor" me fond limit 18,052,899 (tetëmbëdhjetë milion e pesëdhjetë e dy mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH;

Lot 2: "Furnizim vendosje pajisje salle operatore" me fond limit 58,520,377 (pesëdhjetë e tetë milion e pesëqind e njëzet mijë e treqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH;

Lot. 3: "Furnizim vendosje pajisje biomjekësore dhe pediatrike" me fond limit 53,471,119 (pesëdhjetë e tre milion e katërqind e shtatëdhjetë e një mijë e njëqind e nëntëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

Data e zhvillimit të tenderit: 11.06.2018

Kohëzgjatja e kontratës: **Lot 2 –brenda 45 ditëve nga data e lidhjes së kontratës.**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët/lot X, ofertad dekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

Për lotin 2: "Furnizim vendosje pajisje salle operatore" me fond limit 58,520,377 (pesëdhjetë e tetë milion e pesëqind e njëzet mijë e treqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH:

- OE "ADR Trans" pa ofertë ekonomike.
- OE "EUROMED" pa ofertë ekonomike
- OE "FEDOS" shpk, me NIPT K01514009I, me ofertën 51 898 000 (pesëdhjetë e një milion e tetëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë) Lekë pa TVSH.

- OE "Medical Distribution" pa ofertë ekonomike.
- BOE "MONTAL" shpk me NIPT J62009007F me "BIOMETRIC ALBANIA" shpk me NIPT J61827062E, me përfaqësues "MONTAL" shpk me ofertën 45,584,500 (dyzet e pesë milion e pesëqind e tetëdhjetë e katër mijë e pesëqind) Lekë pa TVSH.
- OE "OES DISTRIMED" shpk, me NIPT K31520054N, me ofertën 41,000,000 (dyzet e një milion) Lekë pa TVSH.
- OE "Royal Berat" pa ofertë ekonomike.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. OE "ADR Trans" pa ofertë ekonomike.
2. OE "EUROMED" pa ofertë ekonomike
3. OE "FEDOS" shpk, me NIPT K01514009I, me ofertën 51,898,000 (pesëdhjetë e një milion e tetëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë) Lekë pa TVSH.
4. OE "Medical Distribution" pa ofertë ekonomike.
5. OE "OES DISTRIMED" shpk, me NIPT K31520054N, me ofertën 41 000 000 (dyzet e një milion) Lekë pa TVSH.
6. OE "Royal Berat" pa ofertë ekonomike.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- Shoqëritë, **Royal Berat, Euromed, Medical Distribution** dhe **ADR Trans** nuk kanë paraqitur dokumentacionin e kërkuar në kriteret e përgjithshme dhe të vecanta për kualifikim. Gjithashtu këto shoqëri nuk kanë dorëzuar ofertë ekonomike.
- **Shoqëria "FEDOS":**

I. Për artikullin nr. 2 "Defibrilator", specifikimi teknik i kërkuar është "kapaciteti i baterisë min 200 goditje" ndërsa specifikimi teknik i paraqitur në katalogun përkatës nga ky OE është 150 goditje.

II. Për artikullin nr. 6 "Komplet proktologjie", specifikimi teknik i kërkuar është "Ndriçues LED me jetëgjatësi të madhe, me fuqi të paktën 150 W, me ndriçim të rregullueshëm", kurse specifikimi teknik i paraqitur nga OE në katalog tregon se vetëm për ndriçimin me halogjen fuqia është 160 W, pra jo ndriçim LED, si dhe po në këtë faqe te katalogut është përkthyer ndriçimi LED por me fuqi 5500 K, 200 Lumen. Pra në një rast nuk përputhet lloji i ndricimit ndrsa në rastin tjetër nuk përputhet fuqia në ëat me specifikimet teknike.

III. Për artikullin nr. 8, rezulton se fuqia e kërkuar duhet të jetë jo më shumë se 10 Ë ndësa OE fuqia qe ka ky artikull është 12 W, si dhe jetëgjatësia e LED-it duhet jo më pakë se rreth 50000 orë, mdërsa jetëgjatësia që ka artikulli i paraqitur nga OE është mbi 40000 orë, por pa specifikuar nëse përfaqëson afrohjet të kërkuar në specifikimet teknike.

IV. Për artikullin nr. 10 "Llampë Operatore", rezulton se artikulli i paraqitur nga ky OE nuk plotëson specifikimin e **energjisë së rrezes (mË/m2.lx): 3 ± 1.**

V. Për artikullin nr. 11, "Makinë Anestezie", rezulton se:

1. Frekuenca e respirimit kërkohet 5-100 bpm për modalitet ventilimi të detyruar ndërsa OE në specifikimet teknike të paraqitura në katalog për këtë artikull ka paraqitur frekuencën e respirimit 4-60 bpm.
2. Kërkohet Raporti Inspirim/Ekspirim: 2:1 deri 1:4 (me interval 0.5), ndërsa OE ka paraqitur Raportin Inspirim/Ekspirim: 4:1 deri në 1:6.
3. Kërkohet (Karakteristikat e Monitorimit) presioni në rrugët e frymarrjes: -10÷100 cmH2O, ndërsa artikulli i paraqitur nga OE e ka presionin ne rrugët e frymarrjes -4÷100

cmH₂O. Gjithashtu kërkohet Volumi/minute: 0÷90 Litra/min, ndërsa OE nuk e ka këtë specifikim.

4. Për modulën e monitorimit të gazeve të pacientit: O₂, CO₂, N₂O, Agjente Anestetike, kërkohet Shfaqje e Kurbes O₂. Monitorim i FiO₂, EtO₂. Intevali i matjes: 0÷100 vol%. dhe Shfaqje e Kurbes CO₂. Monitorim i FiCO₂, EtCO₂. Intevali i matjes: 0÷15 vol%. ndërsa OE ka paraqitur Shfaqje e Kurbes O₂. Monitorim i FiO₂, EtO₂. Intevali i matjes: 10÷100 vol%. dhe Shfaqje e Kurbes CO₂. Dhe Monitorim i FiCO₂, EtCO₂. Intevali i matjes: 0÷10 vol.

VI. Për artikullin nr. 13 “Mikroskop operator okulistik”, rezulton se kërkohet “*zmadhim i automatizuar me të pakten 5 nivele APO-kromatik në diapazonin 6.4X-40X, Kendi i perthyerjes të pakten ±15, Platforma e levizjes në akset X-Y me interval 40x40mm dhe Ushqimi 220V / 50Hz*” ndërsa OE ka paraqitur zmadhim të automatizuar me të pakten 5 nivele APO-kromatik në diapazonin 3.7X-22.8X, nuk ka paraqitur kendin e perthyerjes të pakten ±15, platformën e levizjes në akset X-Y me interval 40x40mm dhe ushqimi 220V / 50Hz.

Për sa më sipër rezulton se ky OE nuk përmbush specifikimet teknike për këtë artikull.

VII. Për artikullin nr. 14 “Sistem trapanacioni”, kërkohet me njohje automatike të motorreve dhe rregullim të rrotullimeve deri në jo më pak se 85,000 xhiro/min ndërsa OE në artikullin e ofruar specifikon se rrotullimi është 80 000 xhiro/min.

Gjithashtu përkthimi në gjuhën shqipe për specifikimet teknike të këtij artikulli nga ana e OE nuk është i plotë.

VIII. Për artikullin 19, “C-ARM”, rezulton se:

1. Nuk evidentohet specifikimi për aplikim adult dhe pediatrik.
2. Nuk evidentohet kapaciteti i nxehtësise së anodes mbi 70.000 HU por 24 kHU (pra 24 000 HU).
3. Për Sistemin Dixhital të Imazhit, kërkohet formati i procesimit të imazhit: minimumi 1024x1024x16 bit ndërsa specifikimi teknik për këtë artikull nga OE është 12 bit.
4. Referuar specifikimit teknik diapazoni i rrymes min. 0.2-12 mA varesisht menyres fluoroskopike dhe Fluoroscopia pulsative me zgjedhje të ritmit të pulseve deri në jo më pak se 8 pulse në sekonde, rezulton se OE nuk i përmbush këto specifikime.

- Shoqëria ”OES DISTRIMED”:

I. Për artikullin nr. 1 “Aspirator kirurgjikal”, rezulton se specifikimi teknik “*Aparatura i permbahet standarteve ndërkombetare EN 10079-1*” nuk përmbushet nga OE për këtë artikull.

II. Për artikullin nr. 2, “Defiribilator”, specifikimi teknik “*Monitor LCD me ngjyra; madhesia min 8*”, nuk përmbushet nga ky OE pasi është ofruar me përmasë 7”.

III. Për artikullin nr. 3, “Elektrobisturi”, për specifikimin teknik “*Elektrobisturi me dy dalje monopolare dhe një dalje bipolare*”, rezulton se artikulli I ofruar ka dy kanale dalje prerje monopolare. Gjithashtu specifikimi teknik “*Alarme vizive të ndara me ngjyra dhe akustik në përputhje me normën IEC 60601-2-2*”, nuk përmbushet nga ky OE për këtë artikull.

IV. Për artikullin nr. 4, “Gjenerator Kirurgjikal”, rezulton se specifikimi teknik “*Pincat/instrumentet hemostatike shumë-perdorimesh - 2 cope (një cope për laparoskopë dhe një cope për kirurgji të hapur)*”, nuk përmbushet nga ky OE për këtë artikull pasi një nga pinacat ofrohet njëpërdorimshe.

V. Për artikullin nr. 6, “Komplet proktologjie”, rezulton se specifikimi teknik “*Ndriçues LED me jetegjatesi të madhe, me fuqi të pakten 150W, me ndriçim të rregullueshem*”, nuk përmbushet nga ky OE pasi artikulli i ofruar është Ndriçues Halogen. Gjithashtu specifikimet teknike “*Tub rektoskopie, diameter 16 mm, me gjatesi pune 30 - 35 cm, me obturator dhe Tub rektoskopie, diameter 20 mm, me gjatesi pune 30 - 35 cm, me obturator*”, nuk përmbushen pasi ofrohen Tuba Amnioskopi.

VI. Për artikullin nr. 7, “Llampë baktericidi”, specifikimet teknike “*Energjia e rrezatimit UV mbi 65 µE/cm² dhe Niveli i zhurmës së pajisjes me pak se 35 dB*”, nuk përmbushen nga ky OE për këtë artikull.

VII. Për artikullin nr. 9, “Llampë mobile”, specifikimet teknike “*Lartesi e rregullueshme 70-160cm dhe Intensiteti në 0.5 m mbi 85000 lux, (Intensiteti në 1m mbi 21250 lux)*”, nuk

përmbushen nga ky OE për këtë artikull.

VIII. Për artikullin nr. 10, “Llampë operatore”, specifikimet teknike “*Iluminimi ne 1 m per secilen koke: te pakten 130,000 lux, E pajisur me bateri per autonomi te pakten 2 ore dhe karikues automatik dhe disa ore operimi me batteri*”, nuk përmbushen nga ky OE për këtë artikull.

IX. Për artikullin nr. 11, “Makinë Anestezie”, OE nuk përmbush specifikimet teknike si më poshtë vijon:

1. Makine anestezie e pershtatshme per ventilim NEONATAL, PEDIATRIK dhe ADULT, ventlimi Neonatal nuk specifikohet duke mos përmbushur kërkesat për këtë artikull.
2. Ekran LCD me ngjyra dhe me prekje (touchscreen). Dimensioi minimal: 15", ndërsa OE e ofron artikull me përmasë 12.1”.
3. Fluksi i gazit: 1-120 Litra/min, ndërsa fluksi I gazit I ofruar për këtë artikull nga OE është 35-75 Litra/min.

X. Për artikullin nr. 14 “Sistem trapanacioni”, kërkohet me njohje automatike te motorreve dhe rregullim te rrotullimeve deri në jo më pak se 85,000 xhiro/min ndërsa OE në artikullin e ofruar specifikon se rrotullimi është 80 000 xhiro/min. Gjithashtu kërkohet ndricues LED me jetëgjatësi të madhe, me fuqi të pakten 150W, me ndriçim të rregullueshem, ndërsa OE ofron ndricues Halogjen 150 W.

XI. Për artikullin 19, “C-ARM”, rezulton se:

1. Nuk evidentohet specifikimi për aplikim adult dhe pediatrik.
2. Nuk evidentohet kapaciteti i nxehtësise së anodës mbi 70.000 HU dhe Kapaciteti ftohës i anodes mbi 35.000 HU / min.
3. Referuar specifikimit teknik diapazoni i rrymes min. 0.2-12 mA varësisht mënyrës fluoroskopike dhe Fluoroscopia pulsative me zgjedhje të ritmit të pulseve deri në jo më pak se 8 pulse në sekondë, rezulton se OE nuk i përmbush këto specifikime.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **BOE Montal Sh.p.k me NIPT J62009007F** Adresë: Tiranë, ”Dervish Hima”, 3 kullat K.3, AP 9/2 dhe **Biometric Albania Sh.p.k me NIPT J61827062E** me Adresë Tiranë, Rr “Vllazen Huta” Pallat i Ri Vila Park, Kati 6, me përfaqësues me prokurë të posaçme të bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë

Montal Sh.p.k, se oferta e paraqitur me një të vlerë të përgjithshme prej **45,584,500 (dyzet e pesë milion e pesëqind e tetëdhjetë e katër mijë e pesëqind) Lekë pa TVSH/** pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme .

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [autoritetit kontraktor përfitues] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brënda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 28.06.2018.

Ankesa: Po

(nëse ka) kanë marrë përgjigje në datë 06.08.2018, (dhe vendim KPP 599/2018)

* * *

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Arian Kraja

